



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 74 paragrafi 3.3 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/l-114, nenin 18.2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE** **PËR NËPUNËSIT E SHËRBIMIT PUBLIK**

Neni 1

Themelohet Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik të Komunës së Podujevës, në përbërje:

1. Arianit Shaqiri, udhëheqës i sektorit të gjendjes civile, kryesues
2. Albertina Latifi, zyrtare e personelit 2, anëtare
3. Enis Sheholli, zyrtar i lartë ligjor, anëtar

Neni 2

Komisioni themelohet në mandat tre (3) vjeçar.

Neni 3

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik nr. 06/l-114 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0002919/21, datë 13 janar 2021 për themelimin e Komisionit të ankesave për nëpunësit e shërbimit publik.

U dërgohet;
Të emëruarve
Arkivës

Nr.02-020/04-0008314/21
Podujevë, 03 shkurt 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nxjerr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive: ofrohen nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-615/02-0008758/21
Podujevë, 04 shkurt 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0010320/21 të datës 09.02.2021 të OJQ “Shoqata e Shkrimtarëve të Llapit”, (SHSHLL), të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ “SHOQATA E SHKRIMTARËVE TË LLAPIT”

Neni 1

OJQ “Shoqata e Shkrimtarëve të Llapit”, (SHSHLL), për realizimin e manifestimit, “Ora letrare e Pavarësisë”, që do të mbahet më 17.02.2020 për nder të përvjetorit të 13 të Pavarësisë së Republikës së Kosovës në Bibliotekën e qytetit të Podujevës, mbështetet me mjete financiare, në shumë 230.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ “Shoqata e Shkrimtarëve të Llapit”, (SHSHLL) Podujevë.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0011350/21
Podujevë, 11 shkurt 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, duke u bazuar në masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarra më 11.03.2020 për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit COVID-19, dhe Vendimin nr.prot.01/42 të datës 11 nëntor 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19, merr këtë,

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID-19 (SHTABI EMERGJENT)

Neni 1

Plotësohet dhe ndryshohet përbërja e komisionit të veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik Covid-19, në territorin e Komunës së Podujevës, i ngritur me Vendimin nr.prot.02-020/04-0075461/20 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës më datë 11 dhjetor 2020, dhe atë;

Në vend të znj.Egzona Mustafa-Gashi, ish U.D. Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, emërohet;

➤ **z.Driton Veliu**, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.02-020/04-0075461/20 të datës 11 dhjetor 2020, dhe i njëjti hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

T'u dërgohet,

*Të emëruarit me këtë Vendim.
arkives*

Nr.02-020/04-0012101/21
Podujevë,
12 shkurt 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 17 paragrafi 3 të ligjit nr.04/L-179 për transportin rrugor, nenit 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, në kërkesë të bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacionit të Autobusëve” SH.A Podujevë me nr. prot. 01-400/04-0011800/21 të datës.12.02.2021, merr:

VENDIM

Neni 1

Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A Podujevë, mbështetet/subvencionohet në shumë financiare prej 500€.

Neni 2

Mjeteve financiare ndahen me qëllim për mbulimin e kostos financiare të taksës për marrjen e licencës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe përmes bankës barten në llogarinë e Ndërmarrjes.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


U dërgohet:

- Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve Sh.A Podujevë.
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- Arkivit

Nr.02-400/03-0012243/21
Podujevë, 15 shkurt 2021

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja l) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 nr.20) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.12 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.01-020/04-0037944/19 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 08 maj 2019, i ndërlidhur me Vendimin nr.01-020/04-008629/21 të datës 03 shkurt 2021, merr,

VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A. PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. – Podujevë, emërohet,

z.Bujar Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.01-020/04-0037944/19 të datës 08 maj 2019, dhe Vendimit nr.01-020/04-008629/21 të datës 03 shkurt 2021.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet Vendimi nr.02-020/05-0053551/19 i datës 03 korrik 2019

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
Arkives*

**Nr.02-020/05-0014844/21
Podujevë, 19 shkurt 2021**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E SHFAQJEVE TEATRORE

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet në fushën e aktiviteteve kulturore për shfaqje teatrore për skenën e mbrëmjes dhe shfaqje për fëmijë për repertorin e Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”, nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-016/01-0018829/21
Podujevë, 25 shkurt 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.02-660/11-0018030/21 të datës 24.02.2021 të OJQ Shoqata e peshkatarëve “SHPSR Batllava”, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ -SHOQATA E PESHKATARËVE “SHPSR BATLLAVA”

Neni 1

OJQ Shoqata e peshkatarëve “SHPSR Batllava”, për pastrimin e liqenit të “Batllavës”, në fshatin Orllan, përkatësisht mbledhjen e mbeturinave rreth dhe në brendësi të liqenit dhe bartjen e tyre në deponi, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ Shoqata e peshkatarëve “SHPSR Batllava”.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0018915/21
Podujevë, 26 shkurt 2021

